



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunications Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije

Nr.Prot. 115/1/10

Rregullore

për

Analizat e Tregut dhe Përcaktimin e Ofruesve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT-SMP)

Kjo Rregullore është nxjerr në bazë të neneve 1.1, 1.2, 3.1, 4.1, 4.2, 11.7 dhe 44 të Ligjit mbi Telekomunikacionin Nr. 2002/07, të ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-085 (tutje i njohur si - Ligji i Telekomunikacionit), pika 3.8.3 të dokumentit për politikën e sektorit të Telekomunikacionit të datës 13.06.2007, plani i veprimit të partneritetit Europian, duke e marrë parasysh Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit Europian të 7 Marsit 2002 mbi kornizën e përgjithshme rregullatore për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kornize), Rekomandimi i Komisionit Europian të 11 Shkurtit 2003 (2003/311/EC) së bashku me rekomandimin pasues të 17 Dhjetorit 2007 (2007/879/EC) mbi produktet dhe shërbimet relevante të tregut, subjekt i rregullimit *ex-ante* dhe udhëzimeve të Komisionit Europian mbi analizat e tregut si dhe vlerësimet e fuqisë së ndjeshme në treg sipas kornizës rregullatore të Unionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (2002/C 165/03).

Neni 1

Fusheveprimi dhe Qëllimi i kësaj Rregulloreje

1.1 Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është të implementoj Ligjin mbi Telekomunikacion, lidhur me promovimin e investimeve dhe konkurrencës së lire në tregun e telekomunikimeve në Kosovë, duke krijuar një siguri ligjore përmes përcaktimit të kornizës transparente për analiza të tregut, përcaktimin e

Faqe 1 nga 13

ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg dhe imponimin e obligimeve rregullatore ex-ante.

- 1.2 Kjo rregullore cakton procedurat dhe principet bazë për analizat e tregut, përcaktimin e ndërmarrjeve me FNT dhe imponimin e masave rregullatore te ex-ante, për të zgjidhur problemet e identifikuara te konkurrencës.
- 1.3 Kjo rregullore i merr parasysh aktet relevante ligjore te BE (direktivat, rregulloret, rekomandimet) dhe praktikatat me te mira te vendeve regjionale dhe nderkombetare deri në atë masë sa janë në pajtueshmëri me Ligjin e Telekomunikacionit.

Neni 2

Definicionet

Për qëllim të kësaj Rregulloreje:

2.1 Kuptimi apo definicioni i cilësdo fjalë, frazë apo shprehje sipas ligjit për telekomunikacion do të jetë gjithashtu i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë rregullore;

2.2 Termat dhe shprehjet në vijim do të kenë këtë kuptim:

“Thirrje” një lidhje e krijuar nga mjetet e shërbimeve telefonike të disponueshme publikisht duke lejuar komunikimin e dy-anshëm në një kohë reale.

“Linjat me qira” Pajisje telekomunikuese të cilat ofrojnë kapacitet transparent të transmetimit në mes pikave fundore të rrjetit dhe të cilat nuk përfshijnë ndërrimin sipas kërkesës (funksionet e ndërrimit të cilat përdoruesi mund ti kontrollojë si pjesë e furnizimit të linjave për transfer të shënimeve).

“Operator” një ndërmarrës i cili ofron apo është autorizuar të ofrojë një rrjet të telekomunikimeve publike apo një pajisje e lidhur.

“Qasja” nënkupton të bërit të disponueshëm një infrastrukture të telekomunikimit duke përfshirë ndërtesat), rrjetet dhe/apo shërbimet për një ndërmarrës tjetër sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive dhe jo-ekskluzive, për qëllim të ofrimit të shërbimeve elektronike të komunikimit. Ajo ndër të tjera mbulon:

- 1) Qasjen në elementet e rrjetit dhe pajisjeve të lidhura të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve, me mjete fikse dhe jo-fikse (në veçanti kjo përfshinë qasjen e “local loop” – loaku lokal dhe të pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për të ofruar shërbime përmes “local loop” – laku lokal)
- 2) Qasje në infrastrukturën fizike duke përfshirë ndërtesat, tubacionet dhe direkëve (trarëve)
- 3) Qasje në sistemin e softverit duke përfshirë sistemin përkrahës operacional
- 4) Qasje në përkthimin e numrave apo sistemeve të cilat ofrojnë funksion ekuivalent
- 5) Qasje në rrjetet mobile dhe fikse, në veçanti për roving
- 6) Qasje në sistemet me qasje të kushtëzuar për shërbimet televizive digjitale
- 7) Qasje në rrjetet e shërbimeve virtuale.

“**Konkurrenca efektive**” situata në treg ku asnjëra nga ndërmarrjet nuk është përcaktuar si fuqi e ndjeshme në treg.

“**Tregu relevant**” tregu në terme të shërbimeve/produkteve të ofruara në veçanti hapësirat gjeografike të përcaktuara sipas rregullave të dhëna në këtë Rregullore.

“**Qasje e hapur në lakun lokal**” - ‘**Unbundled access to local loop**’ qasje të hapur të plotë në lakun lokal dhe qasje të ndarë në lakun lokal. Masa për qasje të hapur nuk e detyron ndonjë ndryshim në pronësi të lakut lokal.

“**Laku Lokal**” - ‘**Local loop**’ Një laku lokal i pjesëshëm e cila lidh pikën fundore të rrjetit në objektet e konsumatorit me kornizën kryesore të distribuimit apo pajisje ekuivalente në rrjetin e telefonisë fikse publike.

“**Pika fundore e rrjetit**” një pikë fizike me të cilën një përdoruesi i ofrohet qasje në rrjetin publik të telekomunikimeve. Lokacioni i pikave fundore të rrjetit do të përcaktohet nga autoriteti rregullator dhe do të përfaqësojë një kufi, për qëllime rregullatore, të rrjetit publik të telekomunikimeve.

“**Laku nën - lokal**”, ‘**Local sub-loop**’ një lak lokal i pjesëshëm i cili lidh pikën fundore të rrjetit me objektet e konsumatorit në pikën e koncentrimit apo një pike qasjeje të ndërmjetme të specifikuar, në rrjetin e telefonisë fikse publike.

“Qasje e hapur e plotë në lakun lokale” - Full unbundled access to the local loop” furnizimi për një përfitues me qasje në nyjën lokale apo në nyjën nën-lokale, duke autorizuar përdorimin e spektrit të plotë të frekuencave të qarkut fizik.

“Qasje e përbashkët në lakun lokal” furnizimi për një përfitues me qasje në nyjën lokale apo në lakun nën-lokal të një operatori, duke autorizuar përdorimin e brezit frekuncor duke perjashtuar shërbime e zerit.

“Shërbimet Telekomunikuese” një shërbim i cili konsiston plotësisht apo kryesisht në bartjen e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike , përveç transmetimin e programeve televizive dhe të radios nga rrjeti i përdorur për transmetim (ri-transmetim).

“Interkoneksioni” lidhja fizike apo logjike e rrjeteve të komunikimeve publike të përdorura nga ndërmarrësi i njejtë apo i ndryshëm, në mënyrë që të lejoj përdoruesve të një ndërmarrësi të komunikojnë me përdoruesit e të njejtit apo ndërmarrësit tjetër, apo të ketë qasje në shërbimet e ofruara nga ndonjë ndërmarrës tjetër. Interkoneksioni është një lloj i qasjes specifike.

“Ndërmarrësi” një person fizik ose juridik apo një grup i personave të lidhur nga vyrtyti i kontrollit apo varësisë që është e angazhuar në aktivitete të telekomunikimit në Republikën e Kosovës.

“Rrjeti publik i telefonisë” një rrjet i telekomunikimit i cili përdoret për të ofruar shërbime telefonike publike; ajo përkrah transferin në mes rrjetit të pikave fundore të komunikimeve folëse dhe formave tjera të komunikimit, si faksimili dhe shënimet.

“Rrjeti i telekomunikimit” sisteme transmetuese dhe kur është e mundur pajisje të komutimit dhe burime tjera të cilat lejojnë bartjen e sinjalve në mes të pikave fundore të përcaktuara me tela, me radio, me mjete optike apo mjete tjera elektromagnetike.

“Referenca e ofertës” kushtet e bëra publike nga një operator, sipas të cilës ai bën një zotim për të ofruar qasje në çdo ndërmarrësi e cila kërkon një qasje të tillë.

“Vetë-furnizimi” Skicimi hipotetik i furnizimit për shërbime me shumicë nga aktiviteti biznesor tek aktiviteti tjetër biznesor i operatorit të njejtë, në kuptim të asaj se sa ajo do të ofrohet palëve të treta (p.sh. furnizimi me informacione me shumicë nga qasja në rrjetin e aktivitetit biznesor të operatorit tek dega e shitjes me pakice e operatorit të njejt, për të krijuar shërbime finale të shitjes me pakicë).

Neni 3 Procedurat e analizave të tregut

- 3.1 Analizat e tregut do të drejtohen nga ART. Ato do të fillojnë me një vendim të Bordit të ART.
- 3.2 Qëllimi i analizave të tregut të drejtuara nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (tutje i njohur si ART) do të sigurojë një konkurrencë efektive në fushën e komunikimeve elektronike dhe të parandaloj abuzimin e fuqisë së tregut nga ndërmarrësit me FNT
- 3.3 ART mund të bazojë vendimet e veta për të drejtuar analizat e tregut:
 - 3.3.1 me kërkesë të arsyetuar dhe justifikuar të ndërmarrjeve të interesuara
 - 3.3.2 me kërkesë të arsyetuar dhe justifikuar të institucioneve komunale dhe shtetërore
 - 3.3.3 me vet iniciativë.
- 3.4 Procedurat për analizat e tregut përfshinë fazat në vijim:
 - 3.4.1 Definimin e tregut përkatës (produkte/sherbime dhe gjeografik), karakteristikat etë cilave mund të jenë të tilla sa për të justifikuar imponimin e obligimeve rregullatore ex-ante;
 - 3.4.2 Analizat nëse një treg përkatës është konkurrues në mënyrë efektive dhe në rast se nuk është konkurrues në mënyrë efektive, identifikimi i ndërmarrësve me FNT në atë treg;
 - 3.4.3 Imponimi, amendimi dhe/apo tërheqja e obligimeve rregullatore të ex-ante, të referuara në Nenin 6 të kësaj Rregulloreje me respekt të ndërmarrësve me FNT
- 3.5 ART do të ketë të drejtën të kompletojë vetëm pjesë të procedurave të analizave të tregut, kur e konsideron se për arsye të justifikuara nuk është e mundur të kompletohet e tërë procedura.
- 3.6 Kur e drejton një analizë të tregut, ART do të veprojë në pajtim me Ligjin e Telekomunikimeve dhe mund të marrë parasysh ligjet e Bashkimit Europian,

udhëzimet dhe rekomandimet e adoptuara nga Komisioni Europian, për derisa janë në pajtim me Ligjin e telekomunikacionit dhe këtë Rregullore.

- 3.7 ART, gjatë drejtimit të analizave të tregut, mund të përdor mjete të informacioneve të besueshme, duke përfshirë informatat e mbledhura nga pjesëmarrësit e tregut, në mënyrë të drejtpërdrejt për qëllim të disa analizave të tregut apo informacioneve të ofruara për ART, si pjesë e kërkesave për statistika periodike, si dhe informacioneve të besueshme të mbledhura përmes burimeve publike.
- 3.8 ART e ka të drejtën dhe pjesëmarrësit në treg (ofruesit dhe konsumatorët e shërbimeve të veçanta) e kanë për detyrë të ofrojnë informacione për qëllim të analizave të tregut, brenda 15 ditëve të punës nga data e kërkesës së veçantë nga ART, nëse ART nuk e konstaton ndryshe në mënyrë eksplicite. Në rast se kërkesa e ART injorohet apo nëse ART e kupton se shënimet e ofruara janë mashtruese, ART mund ta përdor fuqinë e saj sipas Nenit 15.5, të Ligjit të Telekomunikacionit.
- 3.9 ART do ta kompletojë procedurën e analizës së tregut brenda katër muajve pas vendimit për të inicuar një analizë të tregut, duke përjashtuar konsultimet mbi analizat e tregut. Kjo periudhë mund të zgjatet me një vendim të arsyeshëm të ART, por jo më shumë se 3 herë dhe jo më shumë se 3 muaj për secilën herë. ART do të synojë të kompletojë analizat e tregut brenda periudhës më të shkurtë të mundshme. Analizat e tregut do të kompletohen me një vendim të ART, lidhur me rezultatet e analizave të tregut, të cilat duhet të inkorporojnë rezultatet e secilës fazë të kompletuar të analizave të tregut.
- 3.10 Pasi ta ketë analizuar tregun përkatës, ART duhet të paraqesë një draft vendim së bashku me materialin përkrahës (duke i kushtuar konsideratë të duhur shënimeve konfidenciale) për konsultim publik. Një konsultim i tillë duhet të zgjasë për një periudhë jo më të shkurtë se 1 muaj. ART do të ofrojë një mundësi për ndërmarrësit, i cili është emëruar si FNT, në draft vendimin, për të pasur qasje të plotë në informacionet për të cilat draft vendimi është i bazuar. Kur drejton analiza të tregut, ART do/duhet të konsultojë Komisionin Kosovar të Konkurrencës. Vendimi final do të mirret nga ART.
- 3.11 Vendimi final mbi rezultatet e analizave të tregut së bashku me materialin përkrahës (duke i kushtuar konsideratë të duhur shënimeve konfidenciale) duhet

të publikohet në web-sajtin e ART. ART do ta informojë ndërmarrësin, i cili është emëruar si FNT, në mënyrë individuale rreth vendimit të ART për të emëruar atë si ndërmarrës me FNT brenda 3 ditëve të punës, për miratimin e vendimit.

- 3.12 ART do të bëjë analizën e tregut përkatës brenda dy vitesh nga miratimi i kësaj rregulloreje. ART do të rishikojë çdo treg nëse mendon se konkurrenca në treg ka ndryshuar, brenda tri viteve pasi të jetë kompletuar analiza e fundit e tregut. Megjithatë, përjashtimisht, periudha për analizat e mëvonshme të tregut përkatës mund të zgjatet deri në tri vite tjera, ku ART-ja do të njoftojë propozimin e arsyetuar për një shtyrje të tillë.

Neni 4

Përcaktimi i Tregjeve Përkatëse

- 4.1 ART e përcakton tregun përkatës duke përcaktuar këto dy karakteristika të tregut përkatës:
- 4.1.1 Tregu përkatës i produkt /shërbimet,
- 4.1.2 Kufijtë gjeografik të tregut
- 4.2 Tregut përkatës i Produktit /shërbime përfshijnë të gjitha produktet apo shërbimet të cilat janë të këmbyeshme apo të zëvendësueshme në mënyrë të mjaftueshme, jo vetëm në terme të karakteristikave të tyre objektive, por nga vyrtyti i cili ato janë të përshtatëshme në mënyrë të veçantë për t'i përmbushur nevojat konstante të konsumatorëve, mimet e tyre dhe qëllimin e përdorimit, por poashtu edhe në terme të kushteve të konkurrencës dhe/apo strukturës së furnizimit dhe kërkesës në tregun përkatës.
- 4.3 Një treg gjeografik përkatës përbëhet nga një hapësirë në të cilën ndërmarrësit janë të përfshirë në furnizim dhe kërkesa të produkteve apo shërbimeve përkatëse, në të cilën hapësirë kushtet e konkurrencës janë të njëjta apo homogjene në mënyrë të mjaftueshme dhe të cilat mund të dallohen nga hapësirat fqinje në të cilat kushtet ekzistuese të konkurrencës janë dukshëm të ndryshme.
- 4.4 Duke i marrë parasysh rekomandimet e Bashkimit Europian mbi produktet dhe shërbimet përkatëse të tregut, të ndjeshme në rregulloren ex-ante, ART e

përcakton listën fillestare të tregjeve përkatëse në territorin e Republikës së Kosovës, si vijon:

- 4.4.1 Qasjen në rrjetin publik telefonik në lokacione fikse.
- 4.4.2 Shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun ofruara në lokacion fiks
- 4.4.3 Shërbimet telefonike nderkombetare te disponueshme për publikun të ofruara në një lokacion fiks
- 4.4.4 Minimumi i linjave me qera (i cili përfshin lloje te specifikuar të linjave me qira deri ne dhe përfshire 2Mb/sek)
- 4.4.5 Origjinimi i thirrjeve në rrjetin publik telefonik të ofruar në një lokacion fiks
- 4.4.6 Terminimi i thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara në një lokacion fiks
- 4.4.7 Shërbimet transite ne rrjetet telefonike publike fikse
- 4.4. Aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshire aksesin e ndare te pjesshem ose te plote)
- 4.4.9 Aksesit me shumice ne broadband
- 4.4.10 Segmente terminuese me shumice te linjave me qera
- 4.4.11 Furnizimi/ofrim me shumic te segmenteve të linjave kryesore - trunk të "Linjat për me qira "
- 4.4.12 Qasja dhe origjinim i thirrjeve në rrjetet publike të telefonisë mobile
- 4.4.13 Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale
- 4.5 ART e ka të drejtën të devijoj nga definimi fillestare tregjeve përkatëse, të përshkruara në Nenin 4.4 të kësaj Rregulloreje. Duke e bërë një gjë të tillë, ART duhet të vlerësoj nëse tregu i ri i definuar i përmbush tri kriteret në vijim:
 - 4.5.1 Prezenca e barrierave të larta dhe jo -tranzitore për të hyrë në treg, të cilat mund të jenë të natyrës strukturore, rregullatore apo ligjore.

- 4.5.2 Një strukture e tregut e cila nuk synon drejt konkurrencës efektive brenda një horizonti kohor përkatës. Aplikimi i këtij kriteri përfshinë edhe ekzaminimin e gjendjes së konkurrencës pas barrierave të hyrjes, dhe
- 4.5.3 Pamajftueshmeria e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të pershtatshme deshtimin e tregut të marre në shqyrtim
- 4.6 Nëse ART nuk e definon tregun përkatës, i cili është i ndryshëm nga ato të listuara në Nenin 4.4 të kësaj Rregulloreje, për qëllimet e analizave të tregut të përshkruara në këtë Rregullore, nëse një treg i tillë nuk i përmbush kriteret e referuara në paragrafin e 5 të këtij neni.

Neni 5

Kriteret për përcaktimin e OFNT

- 5.1 Një ndërmarrës do të identifikohet si OFNT kur ai të jetë përcaktuar me vendim të ART, duke u bazuar në analizat e tregut, dhe do llogaritet si i tillë deri sa Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të përcaktojë me vendimin e vet duke u bazuar në analiza tjera të tregut se ndërmarrësi nuk ka OFNT;
- 5.2 ART e konsideron një ndërmarrës të ketë FNT, kur ai e ka pjesëmarrje prej më shumë se 25 % të tregut të caktuar të telekomunikacionit. Pjesa e tregut matet sipas të të hyrave. Megjithatë, ART mund të zgjedh për të matur pjesëmarrjen e tregut edhe në terme të shërbimeve të ofruara, kur kriteret e tilla do të ishin më të pershtatshme për vlerësimin e fuqisë së tregut, apo në raste kur shënimet e të hyrave nuk vlerësohet lehtë dhe nuk është mjaftë i besueshëm. ART mund të poashtu të zgjedh të masë pjesën e tregut të një ndërmarrësi duke përfshirë shënimet e shërbimeve/produkteve të vet-furnizuara.
- 5.3 Në rast se ART vendos se kriteri i pjesës së tregut nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar emërimin apo mos-emërimin e një ndërmarrësi si FNT, në një treg të caktuar, ART mund të merr parasysh kriteret në vijim:
- Madhësia relative e ndërmarrësit në krahasim me madhësin përkatëse të tregut
 - Aftësin e ndërmarrësit për të influencuar kushtet e tregut

- Kontrollin e qasjes së ndërmarrësit deri tek përdoruesi përfundimtar
- Burimet financiare të ndërmarrësit

5.4 ART mund të përcaktojë se një ndërmarrës me një pjesë të tregut me më pak se 25% në një treg përkatës ka FNT apo e kundërta që një ndërmarrës me pjesë të tregut me më shumë se 25% në një treg përkatës nuk ka FNT. Të gjeturat e tilla duhet të bazohen në kriteret e përcaktuara në Nenin 5.3 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Imponimi i obligimeve rregullative ex-ante

Ndërmarrësi i cili është përcaktuar nga ART se ka FNT duhet ti ndjek obligimet përkatëse, të parapara në Ligjin e telekomunikimeve, në legjislacionin e dytë duke implementuar këtë ligj dhe në licencën e lëshuar për këtë ndërmarrës. Më saktë:

6.1 Obligimi për kontrollim të çmimeve. Çmimet e shërbimeve telekomunikuese duhet të bazohen në kosto (duke marrë parasysh një tarifë të arsyeshme të kthimeve nga investimi) e ofrimit efikas të shërbimeve të tilla, dhe duhet për të njëjtin lloj të shërbimit nga i njëjti ofrues, të jetë identik në tërë Kosovën, apo në tërë hapësirën operuese të ofruesit të shërbimit, nëse ofruesi i shërbimit nuk operon në tërë Kosovën. Metodologjia e cila përdoret për të kalkuluar shpenzimet duhet të promovojë efikasitet në një konkurrencë afatgjate dhe të maksimizojë përfitimet për konsumatorët. ART mund të përcaktojë rregulla të kalkulimit të shpenzimeve për qëllim të kontrollimit të çmimit. Detyrimi për të argumentuar se çmimet rrjedhin nga shpenzimet duke përfshirë një tarifë të arsyeshme të kthimit të investimeve, do të takojë ndërmarrësit i cili ka FNT. ART mund të kërkojë që llogaritë e kalkulimit të shpenzimeve të auditohen nga një auditor i pavarur. Deri sa një ndërmarrës të ketë FNT, ofron justifikim të plotë për çmimet e tij, ART mund të caktojë limit të çmimit për disa shërbime duke marrë parasysh shënimet lidhur me shpenzimet përkatëse të siguruara në bazë të metodës së vlerësimit për shpenzimet indirekte, duke përfshirë krahasimin e çmimeve në shërbimet përkatëse, duke pasur parasysh praktikat më të mira të Shteteve Anëtare të BE dhe vlerësimit të raporteve në mes çmimeve përkatëse me shumicë dhe pakicë. Çmimet e shërbimeve telekomunikuese duhet të jenë:

- Të ndara për ti lejuar konsumatorëve të mos paguajnë për shërbimet të cilat nuk përdoren
- Transparente, jo – diskriminuese dhe i thjesht nga aplikimi i përdoruesit
- Të disponueshme për rishikim publik, dhe
- Të emërtuara në atë mënyrë që zbritjet të jenë të rregulluara për të siguruar se produktet apo produktet e lidhura nuk ndikojnë negativisht në konkurrencë

6.2 Obligimi për të mos i nder-subvencionuar. Ndërmarrësi me FNT nuk duhet të nder-subvencionet për shërbimet të cilat i ofron. Kjo nënkupton se profitet e pranuar nga furnizimi i shërbimeve të veçanta nuk mund të përdoret për të financuar humbjet e shkaktuara nga shërbimet tjera në dëm të konkurrencës në treg.

6.3 Obligimi për ndarjen e kontabilitetit. Ndërmarrësi me FNT duhet qartë të ndajë strukturën organizative dhe shënimet financiare të aktiviteteve të ndryshme në mënyrë që të llogarisë në mënyrë të saktë për profitet dhe humbjet e secilit aktivitet individual komercial. ART mund të përcaktojë rregulla të ndarjes së kontabilitetit për qëllim të implementimit të këtij obligimi.

6.4 Obligimi i qasjes. Në vazhdimësi të kërkesave të përgjithëshme për të siguruar qasje, të cilat janë të dhëna në Ligjin e telekomunikimeve, ndërmarrësit e percaktuar se kanë FNT duhet të ofrojnë qasje në shërbimet përkatëse apo rrjete brenda përcaktimit të ofruar në këtë Rregullore. Një ndërmarrës mund të refuzojë të ofrojë, të suspendojë në mënyrë unilaterale apo ti jape fund qasjes vetëm në rast se veprime të tilla janë të bazuara në kritere objektive, duke përfshirë mos-fizibilitetin apo nevojën për të siguruar integritetin e rrjetit. Çdo refuzim nga ofruesi i shërbimeve sipas këtij paragrafi do të shpërndahet tek përdoruesi jo më vonë se tridhjet (30) ditë pas parashtrimit të kërkesës, dhe duhet të shoqërohet me arsye me shkrim. Në rast të refuzimit të qasjes, ofruesi duhet të informojë ART për justifikimet e tij teknike jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas.

6.5 Obligimi për transparence. Ndërmarrësi me FNT duhet ti bëjë publike informatat mbi shërbimet/produktet e ofruara në tregun përkatës, duke përfshirë:

- 1) Informatat e kontabilitetit
- 2) Specifikimet teknike
- 3) Karakteristikat e rrjetit
- 4) Termet dhe kushtet për furnizim dhe përdorim
- 5) Çmimet e qasjes dhe shërbimet e lidhura.

Ndërmarrësi, i përcaktuar si FNT në treg, duhet të publikojë një ofertë si referencë për të ofruar dhenjen e qasjes përkatëse me shumicë. Oferta duhet të jetë e detajizuar mjaftueshëm për të siguruar se nga ndërmarrësi nuk kërkohet të paguaj për pajisjet të cilat nuk janë të nevojshme për shërbimin e kërkuar, duke e dhënë një përshkrim të ofertave përkatëse të ndara në komponente sipas nevojave të tregut, dhe termeve shoqëruese dhe kushteve duke përfshirë çmimet. ART do të ketë të drejtën të kërkojë që ndërmarrësi i cili ka FNT duhet të ndryshoj, brenda një limiti kohor të dhënë nga ART, termet dhe kushtet e ofertës referuese në mënyrë që të japë efekt obligimeve të imponuara sipas këtij Ligji mbi operatorët me fuqi të ndjeshme në treg. ART mundet më tej të specifikoj informacionin i cili duhet të publikohet nga ndërmarrësi me FNT.

- 6.6 **Mos-diskriminimi.** Ndërmarrësi me FNT nuk duhet të diskriminojë kundër ndërmarrësve të tjerë dhe në veçanti, të aplikojë kushte ekuivalente në rrethana ekuivalente për ndërmarrësit e tjerë të cilët ofrojnë shërbime ekuivalente, dhe ofrojnë shërbime dhe informata të tjerëve sipas kushteve të njejta dhe të kualitetit të njejtë siç i ofronë për shërbimet e veta, apo për nën-njësit apo degët e veta.

Neni 7

Dispozitat përfundimtare

- 7.1 Vendimi i ART lidhur me vlerësimin e FNT duhet të ketë formën, përmbajtjen dhe arsyeshmërin e aktit administrativ të bazuar në Ligjin për Procedura Administrative Nr. 02/L-28, neni 83, 84, 85, 86 dhe duhet të përmbajë së paku informacionet mbi:

- a) Definimin e tregut përkatës, duke përfshirë produktet/shërbimet përkatëse dhe kufijtë gjeografik të tregut,
 - b) Vlerësimin e statusit të konkurrencës dhe emërtimit të ndërmarrësit me FNT, në tregun përkatës,
 - c) Obligimet e imponuara sipas ndërmarrësit të përcaktuar si FNT në tregun përkatës
- 7.2 Aktiviteti apo lënia jashtë e ART në implementimin e kësaj Rregulloreje mund të apelohe në procedurat e përcaktuara nga ligjet e Republikës së Kosovës
- 7.3 ART e publikon në web-sajt listën e ndërmarrësve të përcaktuar se kanë FNT në tregjet përkatëse në Republikën e Kosovës dhe të freskojë atë nëse lista ndryshon.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe validiteti

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj me vendim të Bordit të ART, Nr 115/1/10, datë 20/12/2010, dhe mbetet në fuqi derisa të nxirret një Rregullore tjetër.

Klasa: 01/1
Regj. No.: 5

Prishtinë, 20/12/2010

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit të ART
